

PERIODIKU BANKAR

VËSHTRIM MBI SEKTORIN
FINANCIAR TË KOSOVËS



NORMAT EFEKTIVE TË INTERESIT

PERIODIKU BANKAR



SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS
KOSOVO BANKING ASSOCIATION

 Banka Ekonomike

 **BKT**
BANKA KOMBETARE TREGTARE

 **BPB**

 **iSBANK**

 **NLB Banka**

 **ProCredit Bank**

 **Raiffeisen
BANK**

 **TEB**
BNP PARIBAS JOINT VENTURE

 **ZiraatBank**

PËRGATITUR NGA:

DR. SC. PETRIT BALIJA,
Kryeredaktor

KRESHNIK KOSUMI,
Redaktor

MIRANDA RUGOVAJ
Koordinatore

SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS

DATA E PUBLIKIMIT,
Qershor 2016



SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS
KOSOVO BANKING ASSOCIATION

Deklarata e autorësisë: Materiali në këtë publikim ka të drejta autoriale. Kopjimi apo përdorimi i një pjese apo i tërë publikimit pa leje apo pa shënuar burimin e informacionit mund të konsiderohet shkelje e ligjeve në fuqi.

NORMAT EFEKTIVE TË INTERESIT

PËRMBAJTJA

PJESA I

Normat efektive të interesit 1

Normat efektive të interesit në kredi 1-3

Normat efektive të interesit në depozita 3-4

PJESA II

Indikatorët kryesorë të industrisë bankare të paraqitura në numra dhe figura 5

Struktura e asetëve 5-6

Struktura e detyrimeve 6-8

Të hyrat dhe shpenzimet 8-11

Kreditë jo-performuese 11

PJESA III

Lajme nga industria bankare 14- 18

I.

NORMAT EFEKTIVE TË INTERESIT

Industria bankare vazhdimisht është rritur, me ç'rast në muajin prill të vitit 2016 ka arritur vlerën e aseteve në 3,381.7 miliardë euro. Në këtë kuptim, industria bankare shënoj rritje si në vlerën e gjithsej aseteve, po ashtu shënoj rritje në vlerën e depozitave, kredive, transaksioneve, performancës ndërmjet të hyrave dhe shpenzimeve, duke ofruar kështu siguri, stabilitet dhe qëndrueshmëri, faktorë të cilët janë shumë të rëndësishëm në ngritjen e besueshmërisë të klientëve/qytetarëve të Republikës së Kosovës ndaj industrisë bankare.



Përveç rritjes në vlerë të aseteve, industria bankare ka shënuar rritje të të hyrave sidomos gjatë vitit të kaluar, çka tregon se industria bankare është e shëndoshë dhe ofron qëndrueshmëri dhe siguri në depozitat që qytetarët e Republikës së Kosovës i mbajnë tek industria bankare.

Pavarësisht nga zhvillimi i vazhdueshëm i industrisë bankare, ky sektor ka arritur që vazhdimisht gjithashtu të bëj uljen e normave efektive të interesit në kredi, me ç'rast ka bërë që kostoja e qytetarëve të Republikës së Kosovës për të marrë kredi të jetë më e vogël. Kjo tregon edhe për përkushtimin që industria bankare e ka dhe për rolin e saj të rëndësishëm që e ka në zhvillimin e ekonomisë përmes procesit të kredidhënies.

Normat efektive të interesit në kredi

Kjo ulje e madhe e normave të interesit në kredi nëpër vite mund të vërehet në tabelën 1 të paraqitur.

NORMAT EFEKTIVE TË INTERESIT NË KREDI (2010-2016)							
Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	Prill-16
Norma efektive në kredi të reja	13.97%	13.30%	12.24%	10.90%	9.29%	7.69%	7.66%
Norma efektive për korp.jofinanc.	14.11%	13.04%	12.34%	10.75%	9.56%	7.39%	7.27%
Norma efektive për ek.familjare	13.77%	13.85%	12.00%	11.33%	8.88%	8.39%	7.95%

Tab. 1 | Burimi: BQK – Normat e interesit në kredi për sektorin bankar (qershor 2016)

Sikurse shihet nga tabela normën më të ulët e kanë shënuar kreditë për korporatat jofinanciare, çka tregon edhe njëherë përkushtimin e industrisë bankare në zhvillimin ekonomik të vendit. Rënia e normave të interesit nëpër vite mund të shihet edhe në bazë të figurës 1 të paraqitur. Në rast se krahasojmë fundin e muajit prill 2016 me fundin e vitit 2010, mund të shohim se norma e interesit në kredi të reja ka shënuar rënie për 6.31% (nga 13.97% në 7.66%).




Fig. 1 | Burimi: BQK – Normat e interesit në kredi për sektorin bankar (qershor 2016)

Në figurën 1 mund të shihet se normat e interesit në kredi kanë shënuar ulje për të gjitha llojet e kredive.

NORMAT EFEKTIVE TË INTERESIT NË KREDI TË REJA (2010-2016)							
Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	Prill-16
Mbitërheqjet	12.65%	11.58%	10.26%	9.36%	9.49%	7.36%	7.15%
Linjat kreditore	13.27%	12.12%	11.37%	11.03%	11.76%	8.52%	8.73%
Kreditë konsumuese	14.56%	14.02%	12.37%	11.69%	9.11%	8.74%	8.00%
Kreditë hipotekare	11.20%	11.76%	10.00%	9.72%	7.88%	6.99%	6.74%
Kreditë me kushte favorizuese	7.71%	7.74%	6.30%	5.68%	2.76%	6.23%	2.73%
Bujqësore	21.90%	21.35%	17.29%	13.88%	11.32%	7.07%	10.80%
Industriale	14.94%	12.67%	13.22%	10.97%	8.88%	7.40%	6.95%
Shërbyese	13.83%	13.21%	11.88%	10.53%	9.99%	7.39%	7.48%
Sektorët tjerë	13.81%	-	-	-	9.65%	7.74%	6.40%

Tab. 2 | Burimi: BQK – Normat e interesit në kredi për sektorin bankar (qershor 2016)

Tabela 2 paraqet normat efektive të interesi në kredi të reja të ndara nëpër kategori të ndryshme. Ajo çka vërehet nga tabela është fakti se pothuajse të gjitha nën kategoritë e normave të interesit për kredi të reja kanë shënuar rënie sidomos gjatë dy viteve të fundit.

NORMAT EFEKTIVE TË INTERESIT NË KREDI PËR KORPORATAT JOFINANCIARE (2010-2016)

Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	Prill-16
Mbitërheqjet	12.65%	11.38%	10.20%	9.36%	9.35%	7.11%	6.87%
Linjat kreditore	13.27%	12.12%	11.37%	11.03%	11.76%	8.52%	8.73%
Kreditë me kushte favorizuese	7.62%	8.02%	5.53%	5.97%	2.24%	2.67%	2.93%
Bujqësore	22.44%	21.13%	17.59%	13.88%	11.32%	7.07%	7.40%
Industriale	14.94%	12.67%	13.22%	10.97%	8.88%	7.40%	6.95%
Shërbyese	13.83%	13.21%	11.88%	10.53%	9.99%	7.39%	7.48%
Sektorët tjerë	13.81%	-	-	-	9.65%	7.74%	6.40%

Tab. 3 | Burimi: BQK – Normat e interesit në kredi për sektorin bankar (qershor 2016)

Edhe në tabelën 3 mund të vërehet se trendi i njëjtë rënës i normave të interesit është edhe për kreditë e lëshuara për korporatat jofinanciare, ku kryesisht bëjnë pjesë bizneset e ekonomisë së Kosovës. Në këtë tabelë mund të shohim gjithashtu se të gjitha nënkategoritë e kredive të lëshuara kanë norma efektive njëshifrore të interesit.

Në këtë përbërje është e rëndësishme të theksohet se industria bankare në fund të muajit prill 2016, ka shënuar vlerën prej vetëm 7.4% të normës së interesit për kredi bujqësore, sektor ky i cili llogaritet si më i rëndësishmi për zhvillimin ekonomik të vendit.

NORMAT EFEKTIVE TË INTERESIT NË KREDI PËR EKONOMITË FAMILJARE (2010-2016)

Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	Prill-16
Mbitërheqjet	-	16.44%	11.82%	14.88%	12.92%	12.66%	13.26%
Kreditë konsumuese	14.56%	14.02%	12.37%	11.69%	9.11%	8.74%	8.00%
Kreditë hipotekare	11.20%	11.76%	10.00%	9.72%	7.88%	6.99%	6.74%
Kreditë me kushte favorizuese	7.76%	7.56%	6.83%	5.37%	3.15%	6.23%	2.33%
Bujqësore	19.95%	21.35%	15.04%	-	-	11.91%	11.73%

Tab. 4 | Burimi: BQK – Normat e interesit në kredi për sektorin bankar (qershor 2016)

Krahas sektorëve të ndryshëm ekonomik, industria bankare bën edhe kreditimin e ekonomive familjare, me ç'rast në tabelën 4 mund të shohim se trend i njëjtë i uljes së normave të interesit vazhdon edhe për kategori.

Normat efektive të interesit në depozita

Krahas normave efektive të interesit në kredi, industria bankare për klientët e saj paguan edhe normat të interesit në depozita për mjetet që qytetarët e Kosovës i deponojnë në kuadër të industrisë. Sikurse që mund të shihet nga struktura e detyrimeve të bankave, depozitat e përbëjnë pjesën kryesore të financimit të kësaj industrie, andaj kjo normë e interesit paraqet kryesisht edhe koston e mjeteve që industria bankare i mban në emër të klientëve të saj. Tabela 5 i paraqet këto përqindje.

DIFERENCA NDËRMJET NORMAVE TË INTERESIT NË KREDI DHE DEPOZITA (2010-2016)

Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	Prill - 16
Norma efektive për gjithsej kreditë e reja	13.97%	13.30%	12.24%	10.90%	9.29%	7.69%	7.66%
Norma efektive për gjithsej depozitat e reja	3.38%	3.62%	3.72%	2.40%	1.11%	1.15%	0.85%
Diferenca	10.59%	9.68%	8.52%	8.50%	8.18%	6.54%	6.81%

Tab. 5 | Burimi: BQK – Normat e interesit në kredi për sektorin bankar (qershor 2016)

Normat efektive të interesit në depozita krahas atyre në kredi, kanë shënuar gjithashtu ulje, mirëpo me një trend më të vogël në raport me ato për kredi. Kjo për faktin se diferenca ndërmjet këtyre dy normave, gjithashtu është ngushtuar ndjeshëm nëpër vite, me ç'rast në fund të vitit 2015 ka shënuar vlerën më të ulët në vetëm 6.54%.




Fig. 2 | Burimi: BQK – Normat e interesit në kredi për sektorin bankar (qershor 2016)

Ky trend rënës për të tri këto kategori mund të shihet në figurën 2.

II. INDIKATORËT KRYESORË TË INDUSTRIËS BANKARE

Struktura e asetëve

STRUKTURA E ASETEVE TË INDUSTRIËS BANKARE (2010-2016)
(milion euro)

Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	Prill-16
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	307.0	331.5	425.7	463.3	447.1	491.0	435.9
Bilanci me bankat komerciale	439.1	329.5	287.9	339.9	390.7	316.0	312.2
Letrat me vlerë	173.4	202.0	256.6	354.5	383.8	473.3	445.9
Kreditë dhe lizingu	1,458.7	1,698.1	1,763.4	1,805.8	1,882.4	2,019.5	2,102.5
Asetet fikse	44.0	47.4	57.7	55.5	53.7	57.0	56.7
Asetet tjera	32.9	41.3	38.1	40.3	27.9	28.5	28.5
Gjithsej Asete	2,455.1	2,649.7	2,829.3	3,059.3	3,185.6	3,385.3	3,381.7

Tab. 6 | Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së korporatave të tjera depozituese (qershor 2016)

PËRBËRJA E STRUKTURES SË ASETEVE TË INDUSTRIËS BANKARE (2010 -2016)
(milion euro)

Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	Prill-16
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	12.5%	12.5%	15.0%	15.1%	14.0%	14.5%	12.9%
Bilanci me bankat komerciale	17.9%	12.4%	10.2%	11.1%	12.3%	9.3%	9.2%
Letrat me vlerë	7.1%	7.6%	9.1%	11.6%	12.0%	14.0%	13.2%
Kreditë dhe lizingu	59.4%	64.1%	62.3%	59.0%	59.1%	59.7%	62.2%
Asetet fikse	1.8%	1.8%	2.0%	1.8%	1.7%	1.7%	1.7%
Asetet tjera	1.3%	1.6%	1.3%	1.3%	0.9%	0.8%	0.8%
Gjithsej	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%

Tab. 7 | Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së korporatave të tjera depozituese (qershor 2016)




Fig. 3 | Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së korporatave të tjera depozituese (qershor 2016)

KREDITË SIPAS AKTIVITETIT EKONOMIK (2010 - 2016)											
(milion euro)											
Përshkrimi	Bujqësia	Minierat	Prodhimi	Energjetika	Ndërtimtaria	Tregtia	Hotelet & Restaurantet	Tregti tjetër	Shërbime financiare	Shërbime tjera	Gjithsej
2010	38.2	14.6	127.6	18.0	109.1	521.2	39.5	18.9	22.0	113.6	1,022.8
2011	40.5	17.2	136.7	14.5	116.3	606.2	39.9	23.4	55.0	99.9	1,149.5
2012	43.6	16.2	133.1	15.9	125.2	635.3	38.8	22.7	54.5	108.8	1,194.2
2013	45.8	20.1	131.7	20.8	118.7	640.6	49.2	19.1	68.8	102.6	1,217.4
2014	49.8	19.7	153.0	20.3	107.0	674.5	51.4	18.1	60.6	102.0	1,256.4
2015	59.9	19.2	164.1	17.8	99.5	683.0	50.7	21.3	94.0	123.8	1,333.4
Prill - 16	53.4	19.9	174.9	18.7	100.2	712.9	47.9	21.3	95.9	125.6	1,370.7

Tab. 8 | Burimi: BQK – Kreditë e korporatave të tjera depozituese sipas aktivitetit ekonomik (qershor 2016)

PJESËMARRJA E KREDIVE SIPAS AKTIVITETIT EKONOMIK (2010-2016)											
Përshkrimi	Bujqësia	Minierat	Prodhimi	Energjetika	Ndërtimtaria	Tregtia	Hotelet & Restaurantet	Tregti tjetër	Shërbime financiare	Shërbime tjera	Gjithsej
2010	3.7%	1.4%	12.5%	1.8%	10.7%	51.0%	3.9%	1.9%	2.2%	11.1%	100.0%
2011	3.5%	1.5%	11.9%	1.3%	10.1%	52.7%	3.5%	2.0%	4.8%	8.7%	100.0%
2012	3.7%	1.4%	11.1%	1.3%	10.5%	53.2%	3.2%	1.9%	4.6%	9.1%	100.0%
2013	3.8%	1.7%	10.8%	1.7%	9.8%	52.6%	4.0%	1.6%	5.6%	8.4%	100.0%
2014	4.0%	1.6%	12.2%	1.6%	8.5%	53.7%	4.1%	1.4%	4.8%	8.1%	100.0%
2015	4.5%	1.4%	12.3%	1.3%	7.5%	51.2%	3.8%	1.6%	7.1%	9.3%	100.0%
Prill - 16	3.9%	1.5%	12.8%	1.4%	7.3%	52.0%	3.5%	1.6%	7.0%	9.2%	100.0%

Tab. 9 | Burimi: BQK – Kreditë e korporatave të tjera depozituese sipas aktivitetit ekonomik (qershor 2016)

Struktura e detyrimeve

STRUKTURA E DETYRIMEVE TË INDUSTRIJË BANKARE (2010-2016)							
(milion euro)							
Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	Prill-16
Bilanci nga bankat tjera	70.7	40.0	6.0	16.5	31.6	43.4	70.9
Depozitat	1,936.8	2,104.0	2,279.1	2,449.0	2,537.5	2,702.9	2,651.7
Huatë tjera	23.4	30.4	18.9	13.4	14.1	17.6	17.7
Provizionet e shlyera	0.1	0.2	1.7	2.0	2.9	2.7	2.8
Detyrimet tjera	160.1	191.3	221.4	244.1	229.2	189.1	194.2
Borxhi i ndërvarur	33.5	31.0	31.0	56.3	47.3	36.9	37.9
Obligimet nga pranimet e bankës	-	-	0.5	0.1	-	-	-
Mjetet vetanake	230.4	252.8	270.7	277.8	323.0	392.7	405.3
Gjithsej Detyrime	2,455.1	2,649.7	2,829.3	3,059.3	3,185.6	3,385.3	3,380.4

Tab. 10 | Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së korporatave të tjera depozituese (qershor 2016)

STRUKTURA E DETYRIMEVE TË INDUSTRIISË BANKARE (2010-2016)

Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	Prill-16
Bilanci nga bankat tjera	2.9%	1.5%	0.2%	0.5%	1.0%	1.3%	2.1%
Depozitat	78.9%	79.4%	80.6%	80.1%	79.7%	79.8%	78.4%
Huatë tjera	1.0%	1.1%	0.7%	0.4%	0.4%	0.5%	0.5%
Provizionet e shlyera	0.0%	0.0%	0.1%	0.1%	0.1%	0.1%	0.1%
Detyrimet tjera	6.5%	7.2%	7.8%	8.0%	7.2%	5.6%	5.7%
Borxhi i ndërvuar	1.4%	1.2%	1.1%	1.8%	1.5%	1.1%	1.1%
Obligimet nga pranimet e bankës	-	-	0.0%	0.0%	-	-	-
Mjetet vetanake	9.4%	9.5%	9.6%	9.1%	10.1%	11.6%	12.0%
Gjithsej Detyrime	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%

Tab. 11 | Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së korporatave të tjera depozituese (qershor 2016)




Fig. 4 | Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së korporatave të tjera depozituese (qershor 2016)

Të hyrat dhe shpenzimet

TË HYRAT E INDUSTRIË BANKARE (2010-2016) (milion euro)								
Periudha	Të hyrat nga interesi				Të hyrat nga jo-interesi		Të hyrat nga rivlerësimet	Totali
	Kreditë	Plasmanet me banka	Letrat me vlerë	Të tjera	Tarifat dhe komisionet	Të ardhura tjera operative		
2010	169.6	2.7	3.1	0.4	37.5	3.9	0.0	217.2
2011	186.3	4.1	4.2	0.5	41.7	3.3	0.0	240.1
2012	194.9	2.0	3.0	0.6	44.2	2.4	0.0	247.0
2013	192.5	1.4	2.3	2.0	45.6	3.9	1.2	249.0
2014	190.7	1.1	2.9	2.5	44.6	3.1	0.5	245.3
2015	180.4	0.5	4.4	0.7	47.1	4.0	1.1	238.2

Tab. 12 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave e korporatave të tjera depozituese (qershor 2016)




Fig. 5 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave e korporatave të tjera depozituese (qershor 2016)

SHPENZIMET E INDUSTRIJË BANKARE (milion euro)										
Periudha	Shpenzimet e interesit			Shpenzimet e jo-interesit		Shp.të përgjithshme dhe admin.			Provizioni për taksat	Totali
	Depozita	Huamarrje	Të tjera	Tarifat dhe Komisionet	Provizionet për humbjet e kredive	Shp.personelit	Shp.të përgjithshme	Shp.tjera nga jo-interesi		
2010	49.4	4.8	1.1	7.7	28.3	37.8	37.6	12.6	5.5	184.8
2011	51.3	5.6	1.5	8.5	34.8	40.7	33.5	22.9	5.3	204.1
2012	57.6	3.2	2.3	8.7	50.3	42.3	35.5	24.5	4.0	228.6
2013	58.0	2.6	3.2	9.4	46.1	42.3	35.6	22.5	3.2	223.0
2014	36.4	3.3	4.5	11.1	20.5	42.7	35.1	24.4	6.8	184.8
2015	16.7	3.8	2.1	12.0	-8.4	44.0	35.7	27.8	9.7	143.5

Tab. 13 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave e korporatave të tjera depozituese (qershor 2016)




Fig. 6 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave e korporatave të tjera depozituese (qershor 2016)




Fig. 7 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave e korporatave të tjera depozituese (qershor 2016)

TË HYRAT E INDUSTRIË BANKARE (milion euro)								
Periudha	Të hyrat nga interesi				Të hyrat nga jo-interesi		Të hyrat nga rivlerësimet	Totali
	Kreditë	Plasmanet me banka	Letrat me vlerë	Të tjera	Tarifat dhe komisionet	Të ardhura tjera operative		
Mar-15	45.8	0.2	1.0	0.3	11.0	1.0	0.5	59.7
Mar-16	42.8	0.1	1.0	-0.1	11.5	1.2	1.0	57.6

Tab. 14 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave e korporatave të tjera depozituese (qershor 2016)

SHPENZIMET E INDUSTRIË BANKARE (milion euro)										
Periudha	Shpenzimet e interesit			Shpenzimet e jo-interesit		Shp.të përgjithshme dhe admin.			Provizioni për taksat	Totali
	Depozita	Huamarrje	Të tjera	Tarifat dhe Komisionet	Provizionet për humbjet e kredive	Shp.personelit	Shp.të përgjithshme	Shp.tjera nga jo-interesi		
Mar-15	4.9	0.9	0.7	2.6	4.2	10.5	8.1	5.8	2.0	39.7
Mar-16	3.4	0.9	0.5	4.5	4.3	10.4	8.4	6.6	1.9	40.8

Tab. 15 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave e korporatave të tjera depozituese (qershor 2016)




Fig. 8 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave e korporatave të tjera depozituese (qershor 2016)

Kreditë jo-performuese

KREDITË JO-PERFORMUESE (2010-2016)

Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	Prill-16
Vlera e kredive jo-performuese	86.1	96.8	132.3	157.1	154.4	125.2	121.9
Provizionet për humbje nga kreditë	115.0%	116.7%	112.7%	110.5%	114.4%	115.1%	117.5%

Tab. 16 | Burimi: BQK – Raporti vjetor 2013, 2014 dhe raporti i informatave mujore (maj 2016)

KREDITË JO-PERFORMUESE (2010-2016)

Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	Prill-16
Kreditë jo-performuese (%)	5.9%	5.8%	7.5%	8.7%	8.3%	6.2%	5.8%
NPL rritja/zvogëlimi (%)	51.7%	12.5%	36.6%	18.8%	-1.7%	-18.9%	-2.6%
Përqindja e rritjes kreditore	13.2%	16.4%	3.8%	2.4%	4.2%	7.3%	4.1%

Tab. 17 | Burimi: BQK – Raporti vjetor 2013, 2014 dhe raporti i informatave mujore (maj 2016)




Fig. 9 | Burimi: BQK – Raporti vjetor 2013, 2014 dhe raporti i informatave mujore (maj 2016)

Referencat

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Bilanci i gjendjes i korporatave tjera depozituese sipas maturitetit, qershor 2016, <http://bqk-kos.org/?id=55>;

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Raporti vjetor 2013 dhe 2014, <http://bqk-kos.org/?id=102>;

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Raporti i informatave mujore të sistemit financiar, maj 2015, <http://bqk-kos.org/?id=98>;

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Normat efektive të interesit në kredi të reja, qershor 2016, <http://bqk-kos.org/?id=55>;

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Normat efektive të interesit në depozita të reja, qershor 2016, <http://bqk-kos.org/?id=55>;

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Pasqyra e të ardhurave e korporatave të tjera depozituese, qershor 2016, <http://bqk-kos.org/?id=55>;

PJESA III

LAJME NGA INDUSTRIA BANKARE QË SHËNUAN

MUAJIN PRILL

BANKAT INVESTUESET MË TË MËDHA NË BONO TË THESARIT



Qeveria e Republikës së Kosovës ka mbajtur të mërkurën Ankandin e Bonove të Thesarit KV006-16, ku u ofertuan Obligacione Qeveritare dy vjeçare në vlerë nominale prej 25 milionë euro. Nga kjo shumë, 10 milionë euro do të shërbejnë për ri-financimin e obligacionit të emetuar në mars 2014, kurse pjesa tjetër prej 15 milionë shkon për përkrahje buxhetore. “Në këtë ankand tregu shfaqti kërkesë për blerje në vlerë 70.54 milionë euro kurse ne pranuan vetëm shumën e shpallur paraprakisht e që është 25 milionë euro. Norma e interesit për këtë ankand ishte 1.16% vjetore, gjë që paraqet një dallim prej -147 pikësh bazë krahasuar me normën e interesit të ankandit të kaluar të obligacioneve dy vjeçare, e cila ishte 2.63%”, ka njoftuar Ministria e Financave, shkruan Telegrafi. Blerësit sipas kategorive ishin si vijon: Bankat: 24.85 milionë euro, Kompanitë e Sigurimeve: 0.15 milionë euro. Të hyrat neto nga ky ankand janë 14,979,099.54 euro. (Telegrafi, Agjencia e Lajmeve Ekonomia, 1 prill 2016).

KOSOVARËT INVESTUAN 21 MILIONË EURO JASHTË SHTETIT

Bazuar në të dhënat e fundit të Bankës Qendrore të Kosovës shihet qartë se investimet e huaja direkte (IHD) të pranura në Kosovë deri në shtator 2015 shënuan vlerën prej 270.4 milionë euro, apo 148.6 milionë euro më shumë sesa në periudhën e njëjtë të vitit 2014. Sipas BQK-së, rritja e IHD-ve është rezultat i fluksit më të lartë të hyrjes së IHD-ve ndërsa dallimi kaq i lartë me periudhën e njëjtë të vitit paraprak është edhe për faktin se viti 2014 ishte karakterizuar me shpërndarje të superdividendës dhe me shitje të aksioneve të kompanive të huaja. Edhe investimet direkte të rezidentëve kosovarë në vende të tjera ishin më të larta krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak dhe arritën vlerën prej 20.9 milionë eurosh (16.9 milionë euro deri në shtator 2014). Investimet direkte të rezidentëve kosovarë jashtë ekonomisë së Kosovës janë kryesisht investime kapitale, të cilat në të shumtën e rasteve janë blerje e patundshmërive në vendet e rajonit por edhe në Gjermani dhe Zvicër. (Zëri, 8 prill 2016).



KAMATAT PËR KREDI BIEN NË NJËSHIFRORE



Bankat komerciale në Kosovë kanë ulur normat e interesit për kredi. Kamatat e kredive tashmë kanë rënë në rreth tetë për qind nga mbi 10 e deri në 15 për qind, sa kanë qenë me vjet të tëra. Në raportin e fundit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, thuhet se kjo rënie paraqet një lehtësim të rëndësishëm për qasjen e individëve dhe ndërmarrjeve në financimin bankar. Zvogëlimi i kostos së financimit pritet të shërbejë si faktor i rëndësishëm për nxitjen e rritjes së konsumit dhe investimeve në ekonominë e vendit, thonë ekspertë për çështje ekonomike dhe financiare. Kjo normë është e favorshme për qytetarët dhe bizneset, thotë Flamur Keqa, drejtor i Institutit për Banka dhe Financa në Kosovë. Ai për Radion Evropa e Lirë, thekson se ulja e normave të interesit mund të ndikojë në zhvillimin e veprimtarisë së bizneseve, e gjithashtu edhe tek investimet ndërkombëtare.

“Do të krijohen kushte më të favorshme edhe për biznese, por edhe kredimarrje nga ana e qytetarëve, përkatësisht amvisërisë. Kostoja më e ulët e parave, do të ndikonte në rritjen e konsumit dhe kjo do të ndikojë që bizneset ta zgjerojnë veprimtarinë e tyre dhe, në anën tjetër, të shihen mundësitë e bashkëpunimit apo bashkë-operimit edhe me ndonjë investitor të huaj. Në këtë formë do të ndikohej edhe në rritjen e investimeve të huaja direkte”, thotë Keqa. Ibrahim Rexhepi, drejtor i Qendrës për Hulumtime

Strategjike dhe Sociale “STRAS”, për Radion Evropa e Lirë thotë se konkurrenca në tregun bankar ka ndikuar në uljen e kamatave dhe kjo ulje do të jetë lehtësuese për qytetarët dhe bizneset. Edhe Rexhepi, konsideron se ka hapësirë që këto norma të jenë edhe më të ulëta. “Normalisht, se çdo ulje e normave të interesit për kredi, është lehtësuese për qytetarët dhe bizneset, për shkak se shkalla e ngarkesës është shumë e vogël. Dhe, me një përdorim të mençur të këtyre parave, normalisht se do të ketë zhvillim”.

“A ka hapësirë për ulje të më tutjeshme? Normalisht se hapësira gjithmonë ekziston, por hapësirën duhet kërkuar jashtë bankave, te ambienti për biznes, te funksionimi i shtetit, efikasiteti i institucioneve, posaçërisht te (funksionimi) i gjyqësisë dhe te garantimi i kontratave”, vlerëson Rexhepi. Por, bankat nuk qëndrojnë keq as me fitim. Në raportin e fundit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, thuhet se vitin e kaluar fitimi neto ka arritur në rreth 70 milionë euro apo mbi 22 milionë më tepër se në vitin 2014. Pavarësisht zvogëlimit të kamatave, procedurat mbesin tepër të vështira për të marrë kredi të caktuar. (Radio Evropa e Lirë, Telegrafi, 18 prill 2016).

EKONOMIA E KOSOVËS DO RRIKET PREJ RRETH 3.2 PËRQIND



BQK-ja, ka njoftuar se ekonomia e Kosovës në vitin 2016 pritet të ketë rritje reale prej rreth 3.2 për qind. “Kjo rritje pritet të gjenerohet nga kërkesa e brendshme, ndërsa neto eksportet parashihet të vazhdojnë të kenë kontribut negativ në rritjen e BPVsë”, ka njoftuar BQK-ja. Rritja reale e konsumit të përgjithshëm pritet të jetë 2.1 për qind, bazuar në pritjet që konsumi privat do të rritet me 2.6 për qind dhe konsumi publik do të mbetet i njëjtë me vitin e kaluar. Investimet në vitin 2016 parashihet të shënojnë rritje më të lartë se sa në vitin 2015. (Agjencia e Lajmeve Ekonomia, 18 prill 2016).

BANKAT DHE OJQ-TË OBLIGOHEN T’I DETEKTOJNË TRANSAKSIONET E DYSHIMTA

Veprimet dhe masat që duhet të merren nga 10 subjekte të ndryshme, janë përshkruar në Projektligjin për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit, i aprovuar një ditë më parë në Qeveri.

Parashihen gjoba deri në 1 milion euro, në rast se ato nuk e kryejnë detyrën, shkruan sot Koha Ditore. Subjektet që obligohen të raportojnë dyshimet për shpëlarje parash, ose për financim terrorizmi, janë: bankat; institucionet financiare; kazinotë, përfshirë ato në internet dhe objektet e licencuara të lojërave të fatit; agjentët e pasurive të patundshme dhe ndërmjetësit e pasurive të patundshme; personat

fizikë dhe juridikë që tregtojnë mallra kur pranojnë pagesa në para të gatshme në vlerë prej 10 mijë eurosh ose më shumë; avokatët dhe noterët kur përgatiten, kryejnë ose përfshihen në transaksione për klientët e tyre për aktivitete të caktuara; kontabilistët, auditorët dhe këshilltarët tatimorë; trusti dhe ofruesit e shërbimeve që nuk përfshihen në këtë ligj, të cilët u ofrojnë një numër specifik shërbimesh palëve të treta në baza komerciale; OJQ-të, si dhe; shitësit e metaleve të çmuara dhe tregtarët me gurë të çmuar.

Projektligji, një kopje të të cilit e ka siguruar “Koha Ditore”, përmban të listuara veprimet dhe masat për parandalimin dhe zbulimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, e që duhet të merren nga të gjitha subjektet raportuese para, gjatë, dhe pas ekzekutimit të transaksionit ose krijimit të marrëdhënies afariste. (Koha Ditore, 22 prill 2016).



LUKSEMBURG MBËSHKET ZHVILLIMIN E SEKTORIT BANKAR NË KOSOVË



Shoqata e Bankave të Kosovës është vizituar nga përfaqësuesi i Agjencisë për transfer të teknologjisë financiare (ATTF) nga Luksemburg z. Ben Lyon. Në këtë takim u diskutua për thellimin e metutjeshem të bashkëpunimit në mes të dy institucioneve për të ngritur kapacitetet e sektorit bankar në Kosovë. Drejtori ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës falenderoi z. Lyon si dhe shprehu mirënjohjen e sektorit bankar për Ministrinë e Punëve të Jashtme të Luksemburgut dhe Ambasaden e Luksemburgut në Kosovë për mbështetjen e tyre dhe partneritetin që po ndërtohet në mes të këtyre institucioneve. Z. Balija tha që Luksemburgu është një ndër qendrat financiare më të rëndësishme botërore dhe sistemi bankar në Kosovë mund të përfitoj shumë nga ky bashkëpunim. Në këtë takim u diskutua edhe mbi proceset integruese të Kosovës në arenën ndërkombëtare financiare dhe mundësitë që ATTF ofron për të përgatitur kapacitetet e sektorit bankar për integritet përfshirë këtu edhe adaptimin e standardeve të Basel-it. Z. Lyon njoftoj z. Balija për planet afatgjate të ATTF dhe Ministrisë së Luksemburgut për rajonin e Ballkanit Perëndimorë në aspektin afatmesem dhe afatgjatë. Shoqata e Bankave të Kosovës tanime ka realizuar një numër të trajnimeve të nivelit të lartë në bashkëpunim me ATTF dhe ka planifikuar një program trajnimesh për vitin 2016 i cili do të realizohet me mbështetje

të bankave komerciale në Kosovë. Në takim ishte prezent edhe z. Arben Salihu, Menaxher për trajnime në SHBK. (Ekonomia online, Lajmi.net, Kosova Live 360, Agjencia e Lajmeve Ekonomia, 25 prill 2016).

FILLON AKTIVITETIN FONDI KOSOVAR PËR GARANTIMIN E KREDIVE



Ambasadori i ShBA-ve në Republikën e Kosovës Greg Delawie, i shoqëruar nga Kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, Kryeministri, Isa Mustafa, Ambasadorja e Gjermanisë, Angelika Veits, dhe Guvernatori i Bankës Qëndrore të Kosovës Bedri Hamza, do të flasë me rastin e nisjes së Fondit Kosovar për Garantimin e Kredive (FKGK). Fondi Kosovar për Garantimin e Kredive (FKGK) është një institucion vendor i pavarur dhe i qëndrueshëm, i cili do t'u lëshojë garanci të pjesërishme të kredive institucioneve financiare, duke rritur në këtë mënyrë qasjen në financa për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM-të) në Kosovë. Agjencioni i Sh.B.A.-ve për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), në partneritet me Qeverinë e Kosovës dhe donatorët tjerë, ka nisur themelimin e këtij institucioni me qëllim të lehtësimit të rritjes së kredidhënies për bizneset në Kosovë. (Agjencia e Lajmeve Ekonomia Zëri, Koha Ditore, Kosova Sot, 26 prill 2016).

ËSHTË RRITUR BESUESHMËRIA NË SEKTORIN BANKAR




Presidenti Hashim Thaçi, ka pritur në takim guvernatorin e Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Bedri Hamza. Presidenti Thaçi shprehu interesim që të informohej më hollësisht për punën e BQK-së dhe theksoi mbështetjen e tij, për këtë institucion të rëndësishëm të vendit. Guvernatori i BQK-së, Bedri Hamza, tha se ka zhvillime pozitive në sektorin financiar. “Norma mesatare e interesit është e krahasueshme me atë të shteteve anëtare të BE-së. Është rritur besueshmëria në sektorin bankar”, tha Hamza. Kurse, presidenti Thaçi shprehu besimin e tij të plotë dhe vlerësoi për punën e mirë të këtij institucioni. (Telegrafi, Koha Ditore, 27 prill 2016).

PUBLIKIMET E SHOQATËS SË BANKAVE TË KOSOVËS

“Periodiku Bankar” është botim mujor i Shoqatës së Bankave të Kosovës duke filluar me publikimin e parë në muajin janar të vitit 2014. Publikimet mujore përmbajnë të dhëna dhe vlerësime të përgjithshme mbi sistemin financiar në Kosovë. Çdo publikim mujor trajton çështje të caktuara të sistemit financiar që për vëmendje kryesore ka sektorin bankar në Kosovë.
www.bankassoc-kos.com.





Qendra për Trajnime Bankare

TRAJNIMET E PLANIFIKUARA PËR VITIN 2016:

Certifikimi Ndërkombëtar EFCB

Bazat e Pajtueshmërisë

Lidershipi dhe formimi i Ekipeve

Menaxhimi i Riskut Operacional

Menaxhimi i Porfolios së Riskut Kreditor

IFRS

Nga Zyrtar i TI në Auditor të TI

Mbikëqyrja e Stafit

Mirësjellja në Biznes



Për më shumë informata rreth regjistrimit apo programit, kontaktoni Qendrën për Trajnime Bankare në Shoqatën e Bankave të Kosovës.

038 246 171

kbtraining@bankassoc-kos.com



SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS
KOSOVO BANKING ASSOCIATION

Design: Mithat Sejdiu